



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary*

DATË/A:	04.09. 2019
REFERENC-Ë:	19/4470/1- 634/DMMU
PËR/ZA/TO:	N.T.P." Unikonzum" Vushtri.
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 19/4470/1- 634/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për stacionin e karburanëve në Vushtri, Komuna e Vushtrisë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 44. të LPA (Nr.05/L-031), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** kërkesa e Kompanisë N.T.P.“ Unikonzum” Vushtrri, stacionin e karburanëve në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë. **A r s y e t i m**

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar të kompanisë N.T.P.“ Unikonzum” Vushtrri, stacionin e karburanëve në Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë, në pjesën e ngastrës kadastrale nr. P-70202016-03018-4, numri I lëndës së Çertifikatës 18-5354/19, Zona kadastrale Vushtrri, Komuna e Vushtrrisë.

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-214 për VNM, neni 20, është mbajtur debati publik, dhe me këtë rast, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep **Pëlqim Mjedisor** për stacionin e karburanëve me kapacitet të rezervuarëve V=1x57616, 1x27888 dhe 1x28465 litra nafte dhe benzin, nën kushtet si vijon:

nën kushtet si vijon:

Të ndërtohet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza (seperator për vajra dhe gropa septike) adekuate me standarde dhe konform ligjit;

- Të betonohet dhe izolohet platoja ku janë të vendosur rezervarët e derivateve;

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks.gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks.gov.net](mailto:zsp.mmph@ks.gov.net)



- Të betonohet dhe izolohet platoja e sipërfaqeve operacionale;
- Të bëhet vendosja e kontejnerëve të posaçëm për hedhjen e mbeturinave të ngurta në mënyrë që ambienti rreth lokalitetit të jetë çdo herë i pastër.
- Rregullisht të pastrohet seperatori dhe gropa septike;
- Të bëhet monitorimi i ujit para shkarkimit të tij;
- Të bëhet mbjellja me druj dekorativ dhe barishte e sipërfaqeve të pa gjelbëruara;
- Të përgatitet dhe implementohet plani akcional për raste aksidenti;
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).





**Pëlqimi Mjedisor është kusht për marrjen e Lejes Ndërtimore.**

**Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 te Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:**Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 19/4470/1 - ZSP/44/19 datë: 04.09.2019

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së



Sekretar i Përgjithshëm

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### Neni 31.

#### Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### Neni 35.

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

